

VENDIM
Nr.283 datë 25.6.1992

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMI E KËSHILLIT TË MINISTERAVE NR.307, DATË
29.8.1991 "PËR DETYRAT E TË DREJTAT E AGJENCISË KOMBËTARE TË
PRIVATIZIMIT DHE KOMISIONIT PËRGATITOR TË PROCESIT TË PRIVATIZIMIT"**

Me propozim të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun III, pika 4 të ketë këtë përmbajtje:

"Jep autorizimin, cakton kohën dhe radhën e kalimit të pronës shtetërore në pronë private për njësitë e tregtisë, të artizanatit, të shërbimeve komunale, të mjeteve të transportit automobilistik si dhe të objekteve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit si punishtet e përpunimit të qumështit e fruta-perimeve, koçekë, hangarë, pika të riparimit të ndërmarrjeve të mekanikës bujqësore që ndodhen jashtë vijave kufizuese të qyteteve".

2. Pas pikës 7 të kreut IV shtohet kreu IV/a me këtë përmbajtje:

IV/a Nënkomisionet e privatizimit në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Rendit Publik dhe Shërbimin Informativ Kombëtar.

1. Në Ministrinë e Mbrojtjes pranë divizioneve e reparteve të njësuara me to, në Ministrinë e Rendit Publik pranë degës së rendit publik në rrethe a rajone dhe pranë reparteve autonome dhe në Shërbimin Informativ Kombëtar pranë degëve të shërbimit informativ në rrethe a rajone të funksionojnë, brenda organikave ekzistuese, nënkomisionet e privatizimit.

2. Nënkomisionet e privatizimit në këto organizma, në zbatim të dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, bashkërendojnë punën me agjencitë e privatizimit në rrethe a rajone për problemet e kalimit të pronës shtetërore në pronësi private. Në çdo rast kalimimi pronës nga ana shtetërore në private bëhet nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj në rrethe a rajone, pasi të jetë marrë miratimi nga ministritë përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi